



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 30/6 Prot.

Tiranë, më 30.04. 2025

V E N D I M

Nr. 97, datë 30.04. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën Nr. 157 regj, datë 06.08.2024, të paraqitur nga ankuesja znj.M.A kundër Radio Televizionit Shqiptar³ (në vijim referuar si RTSH), me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “bindjes fetare” dhe “bindjes filozofike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja M.A, parashtron si vijon:

“Unë M.A, gazetares prej 24 vitesh në median e shkruar dhe vizive, autore e mbi 40 reportazheve të suksesshëm, e mijëra lajmeve dhe kronikave në të gjithë Shqipërinë e jashtë saj, intervistave me personalitete të mëdha të vendit e botërorë, jam pushuar nga puna si Redaktore Përgjegjëse e Kulturës, në Departamentin e Lajmeve në RTSH, pas 9 vitesh punë me akuzën se “Kam fyer tolerancën fetare në Shqipëri”, për “racizëm” etj, vetëm sepse kam bindje përparimtare si shumë artistë, gazetarë, animalistë në botë, që nuk janë të detyruar, që si në sistemet totalitare të ndjekin ritet fetare me zor, nuk janë të detyruar të besojnë në fe, e të cilët mund të jenë ateistë dhe jo besimtar me zor, sepse liria e besimit ose e mosbesimit dhe e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutën Shqiptare, neni 24, apo neni 10 i Konventës Europiane, që lejon lirinë e shprehjes, teksa unë nuk detyroj, as kanos kënd të bëjë si unë, as iu heq lirinë e besimit të tjerëve, teksa shpreh idetë e mia që mund t’i përkasin të ardhmës.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim referuar si RTSH.

Përkundrazi, kam qenë unë ajo që iu kam vënë mikrofonin në gojë qindra besimtarëve duke i intervistuar sa herë ka pasur festa fetare, paçka se kam mbuluar sektor tjetër, kam mbuluar kulturën, por ka qëlluar që kam bërë edhe kronika fetare tepër korrekte.

Në shkresën e pushimit nga puna nuk faktohet se për çfarë konkretisht, ku e kam thënë dhe çfarë kam thënë, por dyshoj për një postim timin në FB, ku shprehem se “bojkotoj të festoj Pashkën dhe Bajramin sa kohë këto festa kanë në bazë të tyre therjet masive të kafshëve, sepse nuk besoj që zoti kërkon kurbanë për të nderuar atë”. Ky është vizioni im dhe jo vetëm i imi.

Sa herë ka festa fetare, gazetarë, animalistë, qytetarë në Itali thonë të njëjtat fjalë me indinjim, por nëse në Itali atyre ju referohen, i vënë mikrofonin përpara, tek ne dënohesh në Shqipërinë e Enver Hoxhës. Pra, Enver Hoxha dhe komunistët të dënonin pse besojë në Zot, sot A.P të dënon pse nuk beson në fe, se në Zot unë në fakt besoj, fetë edhe i besoj por jo verbërisht në gjithçka. Por mund të jem edhe ateiste apo jo?

Në fakt, Drejtori i Përgjithshëm më ka pushuar nga puna fill pas takimit tim me Kryetarin e Bashkisë së Gjirokastrës, në Gjirokastrë, ku gjendesha si e dërguar për të ndjekur Festivalin e Gjirokastrës. Pasi e pashë rastësisht në qytet zotin F.G dhe iu ankova për helmimet e qenve të rrugës në këtë qytet, nuk kaluan dy orë dhe më erdhi urdhri që të kthehesha në Tiranë dhe të ndërprisja raportimin tim edhe pse shumë të suksesshëm. Kjo tregon ndërhyrjen e politikës në media, drejtpërdrejt nga kryebashkiaku tek drejtori ynë, me të njëjtën të kaluar politike, A.P, i cili në vend që të mbështesë dhe të nxisë gazetaren e tij që të bëjë kërkime mbi helmimet e kafshëve, të cilët mbrohen me ligj, bën të kundërtën; dënon gazetaren. Por për fat të keq nuk e vërtetoj dot takimin me z.F.G, nuk e mendova çdo të ndodhte dhe nuk kam as foto dhe as video nga takimi, por kjo është thjesht dëshmia ime. Me kthyen në Tiranë dhe dy ditë më pas më pushuan pa paralajmërim, duke qenë edhe me raport mjekësor, duke gjetur postimin tim në FB, të cilin do ta rishkruaja sërish edhe sot. Dmth pse sheh përpara e pse nuk ke vizione pagane por ke vizione Projetës në Shqipëri dënohesh si Nikolla Koperniku dhe Galileo Galilei.

Mendoj se qëndrimi në detyrë i një diktatori me mungesa të theksuara të kulturës demokratike por edhe të kulturës minimale njerëzore si A.P i bën dëm Radio Televizionit dhe gjithë shoqërisë shqiptare, që duhet të bëjë hapa përpara e jo pas. Pas meje në RTSH janë pushuar me dhjetra kolegë pa paralajmërim për arsye absurde. Këto nuk janë reforma por raprezalje që do të kishin tronditur çdo vend evropian demokratik. Edhe sikur një gazetar i vetëm të pushohej nga puna, e jo më me dhjetra, që do të ishte një skandal kombëtar. Pas Festivalit të 11-të, kjo është raprezalja e dytë më e madhe e bërë në RTSH dhe historinë e saj. Një në kohën e Enver Hoxhës dhe një në kohën e A.P.”

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e saj në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në bazë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj dhe ligjin “Për barazinë gjinore në Shoqëri”

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese “*bindja fetare*” dhe “*bindja filozofike*”. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”.**

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”, ndërsa në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, gëma “c”, të po këtij ligji, parashikohet: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 1132/1 prot., datë 21.08.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga RTSH, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

1.1 Me shkresën nr.2407/1 prot., datë 29.08.2024⁴, RTSH ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar si vijon:

Znj. M.A ka filluar marrëdhëniet e punës me institucionin tonë në vitin 2014, në pozicionin me emërtesë “Gazetare e Parë”, në Departamentin e Informacionit TV, në Drejtorinë e Aktualitetit, RTSH. Me vendimin nr.348, datë 29.06.2022, znj.A. , në detyrë “Gazetare e Parë” në Sektorin e Reportazheve, në Njësinë e Emisioneve Tematike, duke filluar nga data 01.07.2022, është transferuar në detyrën “Redaktor Përgjegjës” në Sektorin e Kulturës, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve. Më datë 29.06.2022, znj.M.A ka nënshkruar kontratën e punës me institucionin për pozicionin “Redaktor Përgjegjës” në Sektorin e Kulturës, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.

Në përmbajtje të shkresës nr.1505 prot., datë 19.07.2023, znj. A. ka mbajtur qëndrime që vijnë në kundërshtim me parimet e parashikuara në Kodin e Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale, pasi qëndrimet e saj referuar festës së Kurban Bajramit, janë shprehur në një gjuhë të papërshtatshme për një gazetare të ngarkuar me detyrën e mbulimit të eventeve dhe ngjarjeve kulturore, duke cenuar në këtë mënyrë imazhin e RTSH. Qëndrimet e saj kanë qenë raciste dhe fyese dhe kjo gjë është e patolerueshme për RTSH. Po ashtu, siç rezulton edhe në shkresën nr.1505 prot., znj.A. këto qëndrime i ka mbajtur në hapësira dixhitale, të cilat, janë të dukshme për një grup të pakufizuar përdoruesish, ku çdo mendim që publikohet, ndahet, shpërndahet apo rishpërndahet, mund të jetë i përhershëm, i dukshëm për një kohë të gjatë dhe përhapja e tyre në këto hapësira është e ngjashme me një deklaratë të bërë me mjete të komunikimit masiv. Edhe vetë ankuesja pohon në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit se është shprehur: *“bojkotoj të festoj Pashkën dhe Bajramin sa kohë këto festa kanë në bazë të tyre therjet masive të kafshëve, sepse nuk besoj që zoti kërkon kurbanë për të nderuar atë”*, në një kohë që këto qëndrime nuk mund të mbahen nga një gazetare, e ngarkuar me detyrën e mbulimit të eventeve dhe ngjarjeve kulturore, e cila kudo dhe kurdoherë, duhet të jetë model dhe të mos cenojë imazhin e RTSH.

Neni 15 “Detyrat e punëmarrësit”, pika 1, shkronja “c”, të kontratës së punës që ankuesja ka nënshkruar me institucionin, përcakton shprehimisht se: *“Punëmarrësi duhet të kryejë detyrën e caktuar në kontratë nga punëdhënësi, sipas përshkrimit të vendit të punës, si dhe është i detyruar të zbatojë me rigorozitet Kodin e Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale në RTSH”*, prandaj në respektim të kësaj dispozite, RTSH ka zgjidhur kontratën e punës pasi, znj.A. nuk ka respektuar detyrimin kontraktual për respektimin e Kodit të Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale, më konkretisht: Kreu I “Standardet profesionale”, pika 1.10 *“Në parim, programet e RTSH-së nuk lejojnë përdorimin e shprehjeve vulgare apo përdorimin e gjuhës që nuk është në përputhje me normat e pranura shoqërore. Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se*

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.1132/2 prot., datë 30.08.2024.

pranimi publik në lidhje me shprehje të caktuara është në ndryshim të vazhdueshëm.”, si dhe Kreun II “Larmia dhe Balancimi i Raportimit”, pika nr.2.2 “Larmia e opinioneve”, ku parashikohet se: “Gazetarët dhe redaktorët duhet të shmangin gjuhën e urrejtjes. Kur është e nevojshme, gazetarët parafrazojnë të intervistuarit, me qëllim shmangien e fyerjeve apo fjalëve që nxisin urrejtje.”

Në këto kushte, të gjitha rrethanat e mësipërme konsiderohet shkaqe të justifikuara, pasi punëmarrësi ka shkelur detyrimet kontraktuale dhe Kodin e Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale dhe në këtë rast provohet se shkeljet e detyrimeve kontraktuale, përbëjnë shkak që lidhet me shkeljen nga ana e ankueses të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës, si një fakt brenda vullnetit dhe veprimeve dhe mosveprimeve të tij. Shkaqet e arsyeshme ose jo, të justifikuara ose jo, lidhen me sjelljen e palëve kontraktore në respektimin e detyrimeve reciproke që vijnë nga kontrata e punës e lidhur mes tyre, lidhen me shkeljen ose jo të kushteve të kontratës së punës, me përmbushjen ose jo të detyrimeve që punëdhënësit dhe punëmarrësit i vijnë nga kontrata e punës, nga marrëdhënia juridike e punës, e për rrjedhojë në zbatim të nenit 153 të Kodit të Punës, gjithë sa më sipër, konsiderohen shkaqe të justifikuara që lejojnë punëdhënësin në çdo kohë, të zgjidhë menjëherë kontratën.

Ankuesja ndër të tjera shprehet se: *“Drejtori i Përgjithshëm më ka pushuar nga puna fill pas takimit tim me Kryetarin e Bashkisë së Gjirokastrës, në Gjirokastrë, ku gjendesha si e dërguar për të ndjekur Festivalin e Gjirokastrës. Pasi e pashë rastësisht në qytet zotin F.Gdhe iu ankova për helmimet e qenve të rrugës në këtë qytet, nuk kaluan dy orë dhe më erdhi urdhri që të kthehesha në Tiranë dhe të ndërprisja raportimin tim edhe pse shumë të suksesshëm. Kjo tregon ndërhyrjen e politikës në media, drejtpërdrejt nga kryebashkiaku tek drejtori ynë, me të njëjtën të kaluar politike, A.P, i cili në vend që të mbështesë dhe të nxisë gazetaren e tij që të bëjë kërkime mbi helmimet e kafshëve, të cilët mbrohen me ligj, bën të kundërtën; denon gazetaren.”*, e për këtë arsye përmendim këtu faktin se, Radio Televizioni Shqiptar, në zbatim të Nenit 2 “Deklarata e Qëllimit”, të Vendimit nr.98, datë 22.12.2016 “Për miratimin e Statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, synon të arrijë nivelet më të larta të shërbimit ndaj audiencës dhe angazhohet për të zbatuar vlerat themelore të përbashkëta të mediave të shërbimit publik, ndër të cilat përmendin paanshmërinë për të ofruar informim objektiv, të plotë dhe të padiferencuar, jashtë çdo ndikimi ideologjik, politik, social, fetar, financiar, kulturor, e për rrjedhojë gjithë sa më sipër mbeten në kuadër të pretendimeve të vetë ankueses, pasi nga ana e saj siç shprehet dhe në këtë ankesë, nuk ka prova që mund të vërtetojnë këto pretendime.

Ndryshe nga sa pretendon ankuesja, e cila shprehet se ka qenë me raport mjekësor kur është pushuar nga puna, ju bëjmë me dije se, më datë 25.07.2023, ora 13:00, është zhvilluar takimi për të cilin është mbajtur proces-verbali me nr.1554/1 prot. Në këtë procesverbal rezulton se znj.A. nuk është paraqitur në takim pa paraqitur asnjë arsye si, dhe pa pasur raport paaftësie në punë. Komisioni e ka pritur për gati 30 minuta dhe znj.A. nuk është paraqitur, prandaj komisioni ka forcuar bindjen për mosprezencën dhe shmangien e takimit në shkeljen e detyrimeve të saj kontraktuale.

Referuar dispozitave ligjore, fakteve dhe provave të parashtruara më sipër, RTSH argumenton se ndaj znj.A. nuk ka pasur asnjë formë diskriminimi, pasi:

- Vendimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës është i bazuar në ligj, përkatësisht nenin 153 të Kodit të Punës, si dhe ky vendim është marrë për arsye të mosrespektimit të dispozitave të Kodit të Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës.
- Pavarësisht faktit që ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, ky pretendim nuk rezulton i provuar apo i mbështetur në provat e administruara.
- Radio Televizioni Shqiptar nuk ka ndërmarrë veprime që të krijojnë baza për diskriminimin lidhur me trajtimin e punëmarrësve në venin e punës, duke përfshirë ndër të tjera lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës, sepse është respektuar procedura që parashikon neni 144 I Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Si përfundim, Radio Televizioni Shqiptar nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj saj ose që e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të. Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, RTSH arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese për shkakun e pretenduar nga znj.A. .

2. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore në datën 14.01.2025⁵.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 14.01.2025 me pjesëmarrjen e palës ankuese znj. M.A, e cila u paraqit personalisht dhe subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa RTSH, përfaqësuar nga znj. Kristjana Miçi, me detyrë Specialiste Juriste, në Sektorin e Marrëdhënieve Ligjore, në Drejtorinë Juridike, sipas autorizimit nr.2407/2 prot., datë 05.11.2024.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 30/2 prot., datë 16.01.2025, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga RTSH, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Periudhën kohore gjatë të cilës ankuesja ka qenë e ngarkuar për të ndjekur Festivalin e Gjirokastrës, shoqëruar me aktin përkatës nëpërmjet të cilit ankuesja është caktuar për të kryer këtë detyrë.
- A ka raportuar ankuesja deri në përfundim të Festivalit të Gjirokastrës apo është rikthyer në Tiranë, përpara përfundimit të festivalit? Nëse ankuesja është rikthyer në Tiranë përpara përfundimit të detyrës së përcaktuar për raportimin e Festivalit të Gjirokastrës, kur ka ndodhur kthimi i saj, arsyeja/arsyet e kthimit të ankuses para se të përfundonte festivali dhe aktin/mënyrën se si i është komunikuar ankuses ky fakt.

3.1 Në vijim të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.57 prot., datë 05.02.2025, RTSH ktheu përgjigje, duke informuar ndër të tjera :

⁵ Seancat dëgjimore të datës 05.11.2024 dhe 10.12.2024, nuk u zhvilluan për shkak të pamundësisë objektive dhe për ti dhënë mundësi palës ankuese për të marrë pjesë.

Me shkresën nr. 566/8 prot., datë 22.06.2023 nga Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve është propozuar nisja e grupit të xhirimit për ndjekjen e Festivalit Kombëtar Folklorik në Gjirokastër, për datat 23.06.2023-02.07.2023, pjesë e të cilit ka qenë dhe ankuesja znj. M.A.

RTSH nuk disponon asnjë informacion apo dokumentacion tjetër që mund të vërtetojë përfundimin e ankueses se, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH e ka pushuar nga puna, fill pas takimit me Kryetarin e Bashkisë Gjirokastër z. F.G.

3.2 Nëpërmjet *e-mailit* të datës 17.02.2025, ankuesja deklaroi se, nuk është kthyer në datën 2 korrik në Tiranë siç përcaktohet në shkresë, por është kthyer para afatit në Tiranë dhe në vendin e saj vetëm për 3 ditë të fundit të festivalit është caktuar posaçërisht në Gjirokastër gazetarja A.A .

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në tërësinë e akteve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se:

Ankuesja M.A, është e datëlindjes 07.04.1975 dhe banon në qytetin e Tiranës. Znj. A. , ka qenë në marrëdhënie pune me RTSH, në pozicionin “Redaktor Përgjegjës”, në Sektorin e Kulturës në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.

Ankuesja ka filluar marrëdhëniet e punës me RTSH në vitin 2014, ku në bazë të vendimit nr.332, datë 13.08.2014, të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH është punësuar në pozicionin e punës “Gazetare e Parë”, në Departamentin e Informacionit TV, në Drejtorinë e Aktualitetit RTSH”.

Me vendimin nr.263, datë 28.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, si pasojë e ristrukturimit, ankuesja, nga pozicioni i punës “Gazetare e Parë”, në Departamentin e Informacionit TV, në Drejtorinë e Aktualitetit RTSH” është emëruar në detyrën me emërtesën “Gazetare e Parë”, në “Redaksinë Reportazhe & Speciale”, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve të RTSH-së.

Me vendimin nr.248, datë 14.06.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, si pasojë e ristrukturimit ankuesja, nga pozicioni i punës “Gazetare e Parë”, në “Redaksinë e Reportazhe & Specialeve”, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve të RTSH-së kalon në një detyrë tjetër me emërtesën “Gazetare e Parë”, në Strukturën RTSH 24, në Redaksinë e reportazheve, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.

Me vendimin nr.348, datë 29.06.2022 “*Për lëvizje në detyrë*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, ankuesja, nga pozicioni i punës “Gazetare e Parë”, në Sektorin e Reportazheve, në Njësinë e Emisioneve Tematike, është transferuar në detyrën “Redaktor Përgjegjës”, në Sektorin e Kulturës në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.

Ankuesja ka vijuar të punojë në këtë pozicion pune deri më datë 31.07.2023, moment kur i janë zgjidhur në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punës, bazuar në vendimin nr.345, datë 31.07.2023 “*Për zgjidhje të menjëhershme të marrëdhënies së punës*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të *bindjeve fetare* dhe *bindjeve filozofike*, nga ana e punëdhënësit/ RTSH, lidhur me momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës.

Legjislacioni i zbatueshëm në rastin e marrëdhënies së punës midis ankuseses dhe punëdhënësit/RTSH, është Kodi i Punës si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të posaçme në sektorin e medias audiovizive, ku ankuesja ka qenë e punësuar: ligji nr. 97/2013 “*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Statuti i Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), miratuar me Vendimin Nr. 98/2016, datë 22.12.2016 “*Për Miratimin e Statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)*”, si dhe aktet e brendshme të RTSH, sikurse, Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH, miratuar me vendimin nr.72, datë 23.11.2016, të Këshillit Drejtues të RTSH.

Për pozicionin e punës “Redaktor Përgjegjës”, në Sektorin e Kulturës, në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, ankuesja dhe punëdhënësi/RTSH kanë nënshkruar kontratën individuale të punës me nr.2359/2 prot., datë 29.06.2022, e lidhur me një afat kohor të pacaktuar.(Neni 4, i Kontratës Individuale të Punës).

Në rastin objekt shqyrtimi kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis individit dhe shtetit, pasi punëdhënësi/RTSH është një person juridik publik, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Pra, RTSH është ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) publik.

Rezulton se, me shkresën nr.1505 prot, datë 19.07.2023, me lëndë “*Njoftim për takimin mbi vendimin për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të marrëdhënies së punës*”, punëdhënësi/RTSH ka njoftuar ankuesen për zhvillimin e një takimi në datën 25.07.2023, me qëllim që punëdhënësi t’i komunikonte ankuseses arsyet e vendimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Ndër të tjera në këtë njoftim punëdhënësi/RTSH parashtroi:

“Radio Televizioni Shqiptar ka vendosur të zgjidh në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punës me ju, për shkaqe të justifikuara të cilat nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënies së punës.

Rezulton se nga ana juaj, janë mbajtur qëndrime të cilat vijnë në kundërshtim me etikën profesionale, e mbi të gjitha që vijnë në kundërshtim me parimet themelore që garantojnë të drejtën e shprehjes dhe frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare.

Në rastin konkret, qëndrimet tuaja i janë refruar festës së Kurban Bajramit, por edhe asaj të Krishtlindjes, të shprehura me gjuhë të papërshtatshme për një gazetare, të ngarkuar me detyrën e mbulimit të eventeve dhe ngjarjeve kulturore, e cila kudo dhe kurdoherë, duhet të jetë model dhe të mos cenojë imazhin e Radio Televizionit Shqiptar. Qëndrimet tuaja konsiderohen raciste dhe fyese dhe kjo gjë është e paparanueshme për Radio Televizionin Shqiptar.

Theksohet se qëndrimet tuaja janë mbajtur në hapësira digjitale, të cilat, duke qenë se janë të dukshme për një grup potencialisht të pakufizuar përdoruesish, ku çdo mendim që publikohet, që ndahet, që shpërndahet apo që rishpërndahet, mund të bëhet i përhershëm ose, sidoqoftë, mund të jetë i dukshëm, për një kohë të gjatë, përhapja e tyre në këto hapësira është e ngjashme me një deklaratë të bërë me mjete të tjera të komunikimit masiv. Për këto arsye, edhe në këto hapësira digjitale janë të aplikueshme të gjitha rregullat në fuqi të sistemit ligjor, të cilat parashikojnë përgjegjësi civile dhe penale të përdorimit të gjuhës së urrjetjes për shkak të fesë, si në rastin tuaj.”

Ankuesja ka marrë dijeni në lidhje me takimin e datës 25.07.2023, fakt ky që rezulton i provuar bazuar në deklaram e bërë nga ana e saj gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri më datë 14.01.2025.

Më datë 25.07.2023, është mbledhur në mungesë të ankueses, Komisioni i autorizuar nga punëdhënësi për të zhvilluar takimin me ankuesen, lidhur me vendimin për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës, gjatë të cilit është mbajtur procesverbali me nr.1554/1 prot datë 25.07.2023. Ankuesja pretendoi se, ka qenë në kushtet e pamundësisë për marrë pjesë për shkak se ka qenë me raport mjekësor, duke depozituar në cilësi prove raportin për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhet nga punëdhënësi, lëshuar më datë 28.07.2023, Nr. i regjistrimit AZ 74805, lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare Universitare “Nënë Tereza”. Sipas këtij akti, rezulton se ankuesja ka qenë me raport mjekësor për periudhën 26.07.2023-04.08.2023.

Me vendimin nr.345, datë 31.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, ankueses i është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme marrëdhënia e punës me motivacionin: “*Shkelje të detyrimeve dhe mospërbushje të përgjegjësi të ngarkuara nga kontrata e punës, nga ku rezulton se nga ana e saj janë mbajtur qëndrime të cilat vijnë në kundërshtim me etikën profesionale, e mbi të gjitha që vijnë në kundërshtim me parimet themelore që garantojnë të drejtën e shprehjes dhe frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, shkaqe të cilat nuk lejojnë sipas parimit të mirëbesimit vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të punës”.*

Konstatimet mbi të cilat bazohet punëdhënësi/RTSH për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës të cilat parashtrohen në vendimin nr.345, datë 31.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të

RTSH janë të njëjta me ato të parashtuara nga punëdhënësi në shkresën nr.1505 prot, datë 19.07.2023, me lëndë “Njoftim për takimin mbi vendimin për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të marrëdhënies së punës”, të cilat janë pasqyruar më sipër.

Komisioneri konstaton se, punëdhënësi/RTSH në asnjë moment të procedurës së ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, nuk ka përcaktuar se cilat janë qëndrimet/shprehjet konkrete të cilat vijnë në kundërshtim me etikën profesionale dhe parimet themelore, që vijnë në kundërshtim me parimet themelore që garantojnë të drejtën e shprehjes, frymën e tolerancës dhe bashkëjetesën fetare, të cilat konsiderohen raciste dhe fyese dhe përbëjnë gjuhë urrejtje për shkak të fesë, kur dhe ku i ka mbajtur sipas punëdhënësit ankuesja këto qëndrime. Ankuesja pretendoi para Komisionerit se, arsyeja e pushimit nga puna është një postim që ajo ka bërë në rrjetin social *Facebook*.

Referuar akteve të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, konstatohet se në rrjetin social *Facebook*, në profilin “M.A” është publikuar postimi me këtë përmbajtje: “*PROTESTOJKUNDËR E BOJKOTOJ NJË FESTË SI BAJRAMI, PASHKËT SA KOHË KJO FESTË NGRIHET MBI KRIMIN! NDAL BAJRAMIT! KY NUK MUND TË JETË JETË ZOTI. ZOTI NUK ËSHTË EGOIST SA TË KËRKOJË KURBAN ME PRERJE KOKASH E GJAK. MJAFT IDIOTSISË SË PAFUNDME NJERËZORE!!!!!!*”

Gjatë shqyrtimit të ankesës, punëdhënësi/RTSH konfirmoi se është pikërisht ky qëndrim i ankueses, që ka shërbyer si arsye për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen. Sipas punëdhënësit/RTSH këto qëndrime të ankueses referuar festës së Kurban Bajramit, janë shprehur në një gjuhë të papërshtatshme për një gazetare të ngarkuar me detyrën e mbulimit të eventeve dhe ngjarjeve kulturore, janë qëndrime raciste dhe fyese, të cilat cenojnë imazhin e Radio Televizionit Shqiptar.

Në këto rrethana punëdhënësi/RTSH pretendon se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen është e bazuar në ligj dhe në zbatim të nenit 153, të Kodit të Punës, pasi ankuesja ka shkelur detyrimet kontraktuale, konkretisht neni 15, pika 1, shkronja “c”, të kontratës së punës dhe Kodin e Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale, konkretisht Kreun I, pika 1.10 dhe Kreu II, pika 2.2. Dispozitat e sipërcituara, parashikojnë si vijon:

- Kontrata individuale e punës e nënshkruar midis ankueses dhe punëdhënësit/RTSH, e datës 29.06.2022, në nenin 15 “Detyrat e punëmarrësit”, pika 1, germa “c”, parashikon:

“Punëmarrësi duhet të kryejë detyrën e caktuar në kontratë nga punëdhënësi, sipas përshkrimit të vendit të punës, si dhe është i detyruar:

1. Të zbatojë me rigorozitet:

c. Kodin e Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH;”

- Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH, miratuar me vendimin nr.72, datë 23.11.2016, të Këshillit Drejtues të RTSH, Kreu I, pika 1.10 “Gjuha” dhe Kreu II, pika 2.2 “Larmia e opinionëve” parashikojnë:

1.10 Gjuha

.....
Në parim, programet e RTSH-së nuk lejojnë përdorimin e shprehjeve vulgare apo përdorimin e gjuhës që nuk është në përputhje me normat e pranuar shoqërore.

2.2 Larmia e opinionëve

.....
Gazetarët dhe redaktorët duhet të shmangin gjuhën e urrejtjes. Kur është e nevojshme, gazetarët parafrazojnë të intervistuarit, me qëllim shmangien e fyerjeve apo fjalëve që nxisin urrejtje.

Neni 153 i Kodit të Punës sanksionon se, punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. Në referim të pikës 2, të po kësaj dispozite, vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës, ndërsa sipas pikës 3, të Kodit të Punës, konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.

Sipas nenit 12, të Kodit të Punës, kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

Bazuar në dispozitat e mësipërme të Kodit të Punës të cilat japin kuptimin e marrëdhënies së punës dhe mënyrën e zgjidhjes së kësaj marrëdhënie midis palëve kontraktore punëdhënësi dhe punëmarrësi, Komisioneri ndan të njëjtin qëndrim me punëdhënësin/RTSH, kur shprehet se, shkaqet e arsyeshme ose jo, të justifikuara ose jo, lidhen me sjelljen e palëve kontraktore në respektimin e detyrimeve reciproke që vijnë nga kontrata e punës e lidhur mes tyre, lidhen me shkeljen ose jo të kushteve të kontratës së punës, me përmbushjen ose jo të detyrimeve që punëdhënësi dhe punëmarrësi i vijnë nga kontrata e punës, nga marrëdhënia juridike e punës.

Rezulton e provuar se, punëdhënësi/RTSH ka vendosur të përfundojë marrëdhënien e punës me ankuesen për shkak të qëndrimit të mbajtur nga ankuesja në lidhje me therjen e kafshëve për festat fetare, Bajramin dhe Pashkët, dhe të bëra publike në rrjetin social *Facebook*, në profilin privat të ankuses. Duke i konsideruar këto qëndrime të mbajtura ndaj këtyre festave si gjuhë urrejtje për shkak të fesë, qëndrime që vijnë në kundërshtim me standardet dhe etikën profesionale për një

gazetare dhe që cenojnë imazhin e punëdhënësit/ RTSH, ky i fundit, ka konsideruar se ankuesja ka shkelur detyrimet që burojnë nga kontrata e punës, neni 15, pika 1, germa “g”, pikë e cila vendos detyrime mbi ankuesen në cilësinë e punëmarrëses për të respektuar me rigorozytet Kodin e Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH, i cili ndalon përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Ankuesja pretendon se, është larguar nga puna me pretendimin se ka fyer tolerancën fetare dhe për racizëm, vetëm për shkak të bindjeve të saj si animaliste, bindje të cilat sipas saj nuk i ka vetëm ajo, por edhe shumë gazetarë, artistë apo animalistë të tjerë në botë. Liria e besimit ose e mosbesimit dhe liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutën Shqiptare, neni 24 dhe neni 10 i Konventës Europiane, garanton lirinë e shprehjes, teksa ajo nuk detyron apo kanos persona të tjerë të bëjnë si ajo, as nuk i heq lirinë e besimit të tjerëve, por vetëm shpreh idetë e saj që mund t’i përkasin të ardhmes. Ankuesja deklaron se, nuk është e detyruar të besojë në fe dhe personat mund të zgjedhin të jenë ateistë dhe jo besimtar me zor. Nuk mund të dënohesh se nuk beson në fe, se në zot beson, fetë edhe i beson, por jo verbërisht në gjithçka.

Ankuesja pretendon se, mendimet dhe qëndrimet e saj i ka bërë publike në profilin e saj personal në *facebook*, ndërsa në çdo rast ajo ka qenë gjithmonë korrekte gjatë ushtrimit të detyrës së saj si gazetarë. Ajo thekson se, ka intervistuar qindra besimtarë sa herë ka pasur festa fetare, pavarësisht se ka mbuluar sektor tjetër (kulturën), por ka qëlluar që ka bërë edhe kronika fetare, të cilat kanë qenë gjithmonë korrekte.

Ankuesja pretendoi gjithashtu se, pushimi i saj nga puna ka ndodhur menjëherë pas takimit që ajo ka zhvilluar me Kryetarin e Bashkisë së Gjirokastrës, në Gjirokastrë, ku ndodhej si e dërguar nga punëdhënësi/RTSH për të ndjekur Festivalin e Gjirokastrës. Ankuesja pretendon se, pasi e ka parë rastësisht në qytet zotin F.G i ka shprehur shqetësimin për helmimet e qenve të rrugës në këtë qytet. Nuk kaluan dy orë pas këtij takimi dhe sipas ankueses ajo është është njoftuar që të kthehej në Tiranë dhe të ndërpriste raportimin.

Referuar Kodit të Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale të RTSH, miratuar me vendimin nr.72, datë 23.11.2016, të Këshillit Drejtues të RTSH, standardet editoriale dhe profesionale janë politika të qëndrueshme dhe të vlefshme, që rregullojnë veprimtarinë krijuese në RTSH, në përmbushje të misionit të vet si transmetues publik në shërbim të publikut.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri arrin në përfundimin se, shkeljet që punëdhënësi/RTSH pretendon se janë konsumuar nga pala ankuese nuk kanë të bëjnë me sjelljen e ankueses si punëmarrëse dhe respektimin apo shkeljen e detyrimeve kontraktore që rrjedhin nga kontrata e punës, sepse qëndrimi të cilit i referohet punëdhënësi/RTSH nuk është bërë në ushtrim apo gjatë përmbushjes së detyrave nga ana e ankueses si gazetarë e RTSH/në dhe në cilësinë si punëmarrëse. Qëndrimin e saj në lidhje me therjen e kafshëve gjatë festave fetare të Bajramit dhe Pashkëve, ankuesja e ka publikuar në profilin e saj privat në rrjetin social *facebook* dhe nuk rezulton që ky qëndrimi publik i ankueses të ketë lidhje me veprimtarinë krijuese të

punëdhënësit/RTSH, në përmbushje të misionit të vet si transmetues publik. Qëndrimi i publikuar nga ankuesja është një opinion dhe qëndrim tërësisht personal i ankueses dhe nuk mund të vendoset asnjë lloj lidhje midis tij dhe detyrimeve që ankueses i burojnë nga kontrata e punës, në kuadër të marrëdhënies së saj të punës.

Si punëmarrëse ankuesja mund të shpresonte në mënyrë legjitime të vazhdonte punën për sa kohë që ajo nuk ka shkelur detyrimet që i burojnë nga kontrata e punës, që mund të justifikonin largimin e saj nga puna, sipas nenit 153 të Kodit të Punës. Megjithatë, ankuesja u largua nga puna për shkak të publikimit në profilin e saj në *facebook* të qëndrimit të saj kritik në lidhje me therjen e kafshëve për fetsat fetare të Bajramit dhe Pashkëve.

Komisioneri çmon se, situata e ankueses duhet të krahasohet me atë të punonjësve të tjerë në RTSH sepse rezulton e provuar se ankuesja është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se cilido nga kolegët e saj vetëm për arsye të qëndrimit në lidhje me therjen e kafshëve për festën fetare të Bajramit por edhe të Pashkëve.

Përfundimisht, bazuar në sa më sipër është konstatuar dhe arsyetuar, Komisioneri vlerëson se, ankuesja M.A është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të disfavorshme dhe të pabararartë nga ana e punëdhënësit/RTSH, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga disriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9 “*Ndalimi i diskriminimit*”, pika 2, të tij, parashikon : “2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shkaqet e diskriminimit të pretenduar nga pala ankuese, “*bindjet fetare*” dhe “*bindjet filozofike*”.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të *bindjeve fetare* dhe *bindjeve filozofike*. Komisioneri konstaton se, të dy shkaqet e pretenduara nga ankuesja, parashikohen shprehimisht si shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i LMD.

Neni 24, i Kushtetutës së Shqipërisë, sanksionon se, *liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. Sipas kësaj dispozite Kushtetuese, secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve dhe askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.*

Neni 9, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), garanton lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë. Kjo dispozitë përcakton: “*1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.*”

Fjala “fe” nuk përcaktohet as nga teksti i nenit 9 të KEDNJ dhe as në praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Ky lëshim është mjaft logjik, sepse një përkufizim i tillë do të duhej të ishte mjaft fleksibël për të përqafuar të gjithë gamën e feve në mbarë botën (të mëdha dhe të vogla, të vjetra dhe të reja, teiste dhe joteiste) dhe mjaft specifik për t'u zbatuar në raste individuale, një ndërmarrje jashtëzakonisht e vështirë, në të vërtetë e pamundur⁶.

Në një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me lirinë e fesë dhe besimit sipas KEDNJ, GJEDNJ ka bërë të qartë se shteti nuk mund të përpiqet të përshkruajë atë që përbën një fe ose besim dhe se këto nocione mbrojnë “*ateistët, agnostikët, skeptikët dhe të paimpërsuarit*”, duke mbrojtur në këtë mënyrë ata që

⁶ Guide on Article 9 of the European Convention on Human Rights Freedom of thought, conscience and religion Updated on 31 August 2024, https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_9_eng

zgjedhin "të kenë ose të mos kenë bindje fetare apo të praktikojnë ose të mos praktikojnë fenë"⁷. Këto raste vënë në dukje gjithashtu se feja ose besimi është në thelb personal dhe subjektiv dhe nuk duhet domosdoshmërisht të lidhet me një besim të rregulluar rreth institucioneve.⁸

Ajo që në të vërtetë përbën një "fe" ose "besim" që kualifikohet për mbrojtje, sipas nenit 9, të KEDNJ, ka qenë objekt i gjykimit nga GJEDNJ në çështjen *Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁹, në lidhje me manifestimin e fesë në punë. Në këtë vendim GJEDNJ, thekson se, në dimensionin e saj fetar, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, sipas nenit 9, të KEDNJ-së, është një prej elementeve më jetike që përbëjnë identitetin e besimtarëve dhe konceptimit të tyre të jetës, por është njëkohësisht një pasuri e çmuar për ateistët, agnostët dhe të paineduarit. Liria fetare është kryesisht çështje e mendimit dhe ndërgjegjes individuale. Mbajtja e besimit fetar dhe ndryshimi i fesë apo besimit, është absolut dhe i pakualifikuar. Megjithatë, liria e fesë gjithashtu përfshin lirinë për manifestimin e besimit, vetëm dhe privatisht, por edhe të praktikimit të tij në komunitet me të tjerë dhe në publik. Manifestimi i besimit fetar mund të marrë formën e kultit, mësimdhënies, praktikës dhe kryerjes së riteve. Dëshmia me fjalë dhe me vepra është e lidhur me ekzistencën e bindjeve fetare.

Sipas GJEDNJ, "e drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përmban pikëpamje të cilat arrijnë një shkallë bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie." Edhe aty ku besimi në fjalë arrin nivelin e kërkuar të bindjes dhe rëndësisë, nuk mund të thuhet që çdo veprim i cili në njëfarë mënyrë është i frymëzuar, i motivuar apo i ndikuar prej tij përbën "manifestim" të besimit. Kështu, për shembull, veprimet apo mosveprimet të cilat nuk e shprehin drejtpërdrejt besimin në fjalë ose të cilat kanë vetëm lidhje të largëta me normat e besimit bien jashtë mbrojtjes së nenit 9 të Konventës.

Në mënyrë që të llogaritet si "manifestim" brenda kuptimit të nenit 9, veprimi në fjalë duhet të jetë i lidhur ngusht me fenë apo besimin. Një shembull i tillë do të ishte një veprim adhurimi apo devocioni i cili përbën pjesë të praktikës së një feje apo besimi në një formë përgjithësisht të njohur. Megjithatë, manifestimi i fesë apo besimit nuk është i kufizuar me këto veprime; ekzistenca e një lidhjeje mjaft të afërt dhe të drejtpërdrejtë mes veprimit dhe besimit pas tij duhet të përcaktohet mbi bazën e fakteve të secilës çështje. Në mënyrë të veçantë, kërkuesit nuk i vihet kusht që të konstatojë që ai ose ajo ka vepruar në përmbushje të një detyre të caktuar nga feja në fjalë.

Liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese e garantuar nga neni 22, i Kushtetutës së Shqipërisë.

⁷ GJEDNJ, *S.A.S. kundër Francës* [GC], Nr. 43835/11, 1 korrik 2014, para. 124; GJEDNJ, *Izzettin Doğan dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], Nr. 62649/10, 26 prill 2016, para. 103.

⁸ GJEDNJ, *Dega e Moskës së Ushtrisë së Shpëtimit kundër Rusisë*, Nr. 72881/01, 5 tetor 2006, para. 57-58; GJEDNJ, *Kisha Metropolitane e Besarabisë dhe të tjerëve kundër Moldavisë*, Nr. 45701/99, 13 dhjetor 2001 para. 114; GJEDNJ, *Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë* [GC], Nr. 30985/96, 26 tetor 2000, para. 62 dhe 78.

⁹ GJEDNJ, *Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesat nr. 48420/10, nr. 59842/10, nr. 51671/10 dhe nr. 36516/10; Vendim datë 15 janar 2013.

KEDNJ, garanton lirinë e shprehjes në nenin 10 të saj, në të cilin sanksionohet: *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, garantohet edhe në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike¹⁰. Në nenin 18, të Paktit parashikohet:

“1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.

2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.

3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.

4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.”

Komiteti për të Drejtat e Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 22: Neni 18 (Liria e Mendimit, ndërgjegjes ose fesë), ka mbajtur qendrimin se:

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (e cila përfshin lirinë për të pasur besime) në nenin 18.1 është e gjerë dhe e thellë; përfshin lirinë e mendimit për të gjitha çështjet, bindjet personale dhe përkushtimin ndaj fesë ose besimit, qoftë i manifestuar individualisht ose në bashkësi me të tjerët.

.....

¹⁰ Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966.

Neni 18 mbron besimet teiste, joteiste dhe ateiste, si dhe të drejtën për të mos deklaruar asnjë fe apo besim. Termat "besim" dhe "fe" duhet të interpretohen gjerësisht. Neni 18 nuk kufizohet në zbatimin e tij në fetë tradicionale ose ndaj feve dhe besimeve me karakteristika apo praktika institucionale të ngjashme me ato të feve tradicionale. Prandaj Komiteti sheh me shqetësim çdo tendencë për të diskriminuar çdo fe ose besim për çfarëdo arsye, duke përfshirë faktin se ata janë të sapokrijuar ose përfaqësojnë pakica fetare që mund të jenë objekt armiqësie nga ana e një komuniteti fetar mbizotërues.

.....

Nëse një grup besimesh trajtohet si ideologji zyrtare në kushtetuta, statute, shpallje të partive në pushtet, etj., ose në praktikën aktuale, kjo nuk do të rezultojë në asnjë cenim të lirive sipas nenit 18 ose të ndonjë të drejte tjetër të njohur sipas Marrëveshje dhe as në ndonjë diskriminim ndaj personave që nuk e pranojnë ideologjinë zyrtare ose që e kundërshtojnë atë.”

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, në nenin 10, parashikon lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, duke sanksionuar:

“1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë nënkupton lirinë për ta ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë për t'i manifestuar ato në mënyrë individuale ose kolektive, publike ose private nëpërmjet kultit, mësimi, praktikimit dhe kryerjes së riteve.

2. E drejta e mospranimit, për arsye ndërgjegjeje, për të kryer shërbimin ushtarak njihet në përputhje me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.”

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimit, rezulton se, largimi nga puna i ankueses ka ndodhur për shkak të publikimit nga ana e ankueses në profilin e saj në rrjetin social facebook të qëndrimeve të saj kritike në lidhje me therjen e kafshëve gjatë festave fetare të Bajramit dhe Pashkëve. Punëdhënësi/RTSH ka konsideruar se ankuesja ka shkelur detyrimet që i burojnë nga kontrata e punës me RTSH, pasi ka vlerësuar se qëndrimi dhe opinioni i bërë publik në profilin e saj në rrjetin social facebook janë shprehur në një gjuhë të papërshtatshme, në kundërshtim me standardet dhe parimet editoriale të RTSH dhe përbëjnë sipas punëdhënësit gjuhë urrejtje për shkak të besimit fetar.

Në parashtrimet e saj, ankuesja pretendon se, është larguar nga puna vetëm për shkak të bindjeve të saj si animaliste, bindje të cilat sipas saj nuk i ka vetëm ajo, por edhe shumë gazetarë, artistë apo animalistë të tjerë në botë. Liria e besimit ose e mosbesimit dhe liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutën Shqiptare, neni 24 dhe neni 10 i Konventës Evropiane. Ankuesja deklaroi se nëpërmjet manifestimit të bindjeve të saj si animaliste ajo nuk detyron apo kanos persona të tjerë të bëjnë si ajo, as nuk i heq lirinë e besimit të tjerëve, por vetëm shpreh idetë e saj. Ankuesja deklaroi se, nuk është e detyruar të besojë në fe dhe personat mund të zgjedhin të jenë ateistë dhe jo besimtar me zor. Nuk mund të dënohesh se nuk beson në fe, se në zot beson, ndërsa fetë edhe i beson, por jo verbërisht në gjithçka.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi si dhe standardet dhe rregullimet ligjore në fuqi, Komisioneri vlerëson se, nuk kemi të bëjnë me manifestim të besimit fetar apo mungesë të pasjes së bindjeve fetare nga ana e ankueses. Në çështjen në shqyrtim, faktet dhe rrethanat të cilat rezultojnë të provuara, si dhe në bazë të pretendimeve të palëve të parashtruara para Komisionerit, rezulton se, janë bindjet animaliste të cilat ankuesja i ka manifestuar publikisht, të cilat kanë shërbyer si shkak për vendimmarrjen e punëdhënësit në zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen.

Rezulton plotësisht e provuar se, është pikërisht postimi që ankuesja ka bërë në lidhje me festën e Bajramit, por ku referon edhe tek festa e Pashkëve, që ka shërbyer si motivacion për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen, duke i konsideruar qëndrimet dhe opinionin e publikuar të ankueses, si gjuhë urrejtje me bazë fetare. Pra, në këtë rast, e drejta e punësimit të ankueses është cenuar nga punëdhënësi për shkak të bindjeve si animaliste të manifestuara publikisht nga ana e saj, ndërsa bindjet fetare në këtë rast pretendohen nga punëdhënësi si një shkak i ligjshëm për ndërhyrjen në të drejtën për punësim të ankueses, duke pretenduar se gjuha e përdorur nga ankuesja, përbën gjuhë urrejtje për shkak të besimit fetar. Sa më sipër, Komisioneri nuk e vlerëson të bazuar pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve fetare.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri do të vlerësojë nëse bindjet animaliste të ankueses do të konsiderohen bindje filozofike dhe më pas, nëse ankuesja e mbart apo jo këtë shkak.

LMD, nuk ka një parashikim se çfarë konsiderohet bindje filozofike. Mungesa e një përkufizimi se çfarë do të konsiderohet bindje filozofike, si shkak i mbrojtur nga diskriminimi, konstatohet edhe për sa i përket praktikës gjyqësore. Për të vlerësuar nëse bindjet animaliste përfshihen në kuadër të shkakut të mbrojtur të bindjeve filozofike, sipas përcaktimeve të LMD, Komisioneri do të referohet praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)

Komisioneri konstaton se, GJEDNJ ka elaboruar idenë e “*bindjes*” në kontekstin e së drejtës për arsimim sipas nenit 2 të Protokollit 1 të KEDNJ, i cili parashikon se shteti duhet të respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar që arsimimi i fëmijës së tyre të jetë “*në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike*”, duke mbajtur qëndrimin se:

“Në kuptimin e saj të zakonshëm, fjala “bindje”, e marrë në vetvete, nuk është sinonim me fjalët “opinione” dhe “ide”, siç janë përdorur në nenin 10 [...] të Konventës, i cili garanton lirinë e shprehjes; është më shumë i ngjashëm me termin “besim” (në tekstin francez: “bindje”) që paraqitet në nenin 9 [...] dhe tregon pikëpamje që arrijnë një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie.”¹¹

¹¹ GJEDNJ, *Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 7511/76 dhe 7743/76, 25 shkurt 1982, para. 36.

GJEDNJ ka pranuar, se, veganizmi¹² dhe kundërshtimi i manipulimit të produkteve me origjinë shtazore ose të testuara, konsiderohet bindje filozofike¹³.

Në çështjen *Executief van de Moslims van België dhe të tjerë kundër Belgjikës*¹⁴ për herë të parë GJEDNJ duhet të shqyrtonte nëse mbrojtja e mirëqenies së kafshëve mund të lidhej me ndonjë nga qëllimet e përmendura në nenin 9 të Konventës. GJEDNJ u shpreh se, neni 9 nuk përmend në mënyrë të qartë mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve si një qëllim legjitim që mund të justifikojë ndërhyrjen në lirinë për të shprehur fenë. Megjithatë, Gjykata konsideroi se mbrojtja e moralit publik, që përmendet në nenin 9, nuk mund të kuptohet si e kufizuar vetëm në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Konventa nuk është indiferente ndaj mjedisit të gjallë të individëve nën mbrojtjen e saj, dhe kafshët janë pjesë e këtij mjedisi. Për pasojë, Konventa nuk mund të interpretohet si një instrument që kërkon zbatimin absolut të të drejtave dhe lirive që përmban, pa marrë parasysh vuajtjet e kafshëve.

GJEDNJ theksoi se koncepti i “moralit” është në vetvete i zhvillueshëm dhe e ka njohur mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve si një vlerë etike gjithnjë e më e rëndësishme në shoqëritë demokratike moderne. Për rrjedhojë, Gjykata pranoi se mbrojtja e mirëqenies së kafshëve mund të konsiderohet si pjesë e “moralit publik”, dhe për rrjedhojë si një qëllim legjitim sipas nenit 9 të Konventës.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE), në çështjen *Centraal Israëlitisch Consistorie van België dhe të tjerë*¹⁵, konstatoi se, e drejta e BE-së, lexuar nën dritën e nenit 13 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE-së) dhe nenit 10 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian nuk e pengon një shtet anëtar që të kërkojë, në kontekstin e therjes rituale, përdorimin e një metode trulllosjeje që është e kthyeshme dhe që nuk shkakton vdekjen e kafshës. Gjykata vlerësoi se masat e përfshira në aktin e kundërshtuar mundësojnë arritjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet rëndësisë që i jepet mirëqenies së kafshëve dhe lirisë së besimtarëve (hebrej dhe myslimanë) për të shprehur fenë e tyre, dhe janë, rrjedhimisht, proporcionale. Gjykata pranoi se, mbrojtja e mirëqenies së kafshëve është një objektivi i interesit të përgjithshëm të njohur nga Bashkimi Evropian dhe se kur janë në lojë disa të drejta dhe parime themelore të sanksionuara në Traktate, siç është, në këtë rast, e drejta e garantuar në nenin 10 të Kartës dhe mirëqenia e kafshëve e sanksionuar në nenin 13 të TFBE-së, vlerësimi i respektimit të parimit të proporcionalitetit duhet të bëhet në përputhje me nevojën për të pajtuar kërkesat për mbrojtjen e atyre të drejtave dhe parimeve të ndryshme që janë në diskutim, duke arritur një ekuilibër të drejtë ndërmjet tyre. Ashtu si KEDNJ-ja, edhe Karta është një instrument i gjallë që duhet interpretuar në dritën e kushteve

¹² Praktika e mos ngrënies ose mos përdorimit të produkteve shtazore, si mishi, peshku, vezët, djathi ose lëkura: <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/veganism>

¹³ *W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Komisionit i 10 shkurtit 1993.

¹⁴ *Executief van de Moslims van België dhe të tjerë kundër Belgjikës* (Kërkesa nr. 16760/22 dhe 10 të tjerë), vendim i datës 13 shkurt 2024.

¹⁵ Vendim datë 17.12.2020, *Centraal Israëlitisch Consistorie van België dhe të tjerë*, C-336/19, EU:C:2020:1031.

aktuale dhe ideve që mbizotërojnë sot në shtetet, me pasojën që duhet marrë në konsideratë ndryshimi i vlerave dhe ideve.

Animalistët janë persona të cilët mbrojnë të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve në të gjitha aspektet. Ata nuk pranojnë që kafshët të shfytëzohen as për ushqim, as për veshje, argëtim, eksperimente të ndryshme ose forma të tjera dhe kërkojnë respekt absolut ndaj jetës së kafshëve. Animalistët besojnë se kafshët kanë vlerë morale dhe të drejta që duhen respektuar njësoj si njerëzit.

Të drejtat e kafshëve, të drejta morale ose ligjore u atribuohen kafshëve jo-njerëzore, zakonisht për shkak të kompleksitetit të jetës së tyre njohëse, emocionale dhe sociale ose aftësisë së tyre për të përjetuar dhimbje ose kënaqësi fizike ose emocionale. Historikisht, pikëpamjet e ndryshme të fushës së të drejtave të kafshëve kanë pasqyruar zhvillimet filozofike dhe juridike, konceptet shkencore të natyrës së kafshëve dhe njerëzve, dhe konceptet fetare dhe etike të marrëdhënies së duhur midis kafshëve dhe qenieve njerëzore. Që nga fillimi i lëvizjes moderne për të drejtat e kafshëve, e cila u iniciua nga filozofët në vitet 1970, të drejtat e kafshëve kanë qenë një temë e njohur diskutimi brenda studimit akademik të etikës së aplikuar, ose aplikimit të teorive etike normative në problemet praktike. Trajtimi i duhur i kafshëve është një pyetje shumë e vjetër. Filozofët e lashtë grekë dhe romakë debatuan për vendin e kafshëve në moralin njerëzor. Parimi themelor i lëvizjes moderne për të drejtat e kafshëve është që shumë kafshë jo-njerëzore kanë interesa thelbësore që meritojnë njohje, konsideratë dhe mbrojtje. Sipas mbrojtësve të të drejtave të kafshëve, këto interesa themelore u japin këtyre kafshëve si të drejta morale, ashtu edhe të drejta ligjore.¹⁶

Komisioneri vlerëson se bindjet e personave të cilët mbrojnë të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve, pra të animalistëve, janë pikëpamje që arrijnë një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie. Duke mbajtur në konsideratë edhe praktikën e mësipërme të GJEDNJ dhe GJDBE, Komisioneri vlerëson se bindjet animaliste, duhet të gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut “*bindje filozofike*”, të parashikuar nga neni 1, i LMD.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, zgjidhja e marrëdhënies së punës së ankueses nga ana e punëdhënësit/RTSH ka ndodhur për shkak të publikimit që ankuesja ka bërë në profilin e saj personal në rrjetin social “*Facebook*” në lidhje me therjet e kafshëve gjatë festës fetare të Bajramit, e cila kremtohet nga besimtarët myslimanë, por edhe të Pashkëve, për besimtarët e krishterë. Nëpërmjet këtij publikimi, ankuesja shpreh protestën dhe kundërshtimin e saj për therjen masive të kafshëve që bëhet gjatë këtyre periudhave. Sipas ankueses, therja e kafshëve është një krim dhe se kjo nuk mund të jetë një kërkesë e zotit, por ndodh nga njerëzit. Gjatë shqyrtimit të ankesës, ankuesja deklaroi se ajo beson në zo, por jo në çdo gjë që thuhet nga fetë.

Nga verifikimet e kryera kryesisht nga ana e Komisionerit në internet, u konstatua se, të paktën që prej vitit 2020, ankuesja në raste të ndryshme bën publike në internet, pikëpamjet e saj në lidhje me të drejtat e kafshëve.

¹⁶Encyclopedia Britannica, <https://www.britannica.com/topic/animal-rights>

Kështu, në vitin 2020, ankuesja rezulton të ketë bërë një publikim të ngjashëm në lidhje me therjen e kafshëve për kremtimin e festave fetare, qoftë Bajram apo Pashkë. Ndër të tjera ajo shprehet se: *“....nuk besoj që Zoti i mirë urdhëron therje kafshësh, lebeti, vuajtje krijesash të tij me kurbane e me plot dëshirë për këtë Masakër të atyre që nuk kanë zë.Nuk do ta festoj kurrë asnjë festë fetare qoftë Bajram qofshin Pashkët, sepse këto festa kërkojnë kurbane. Do t'i festoj por pa kurbane. Gëzuar Bajramin Pa KURBAN BAJRAM.....”*

Gjatë verifikimeve të kryera në internet, u konstatua se, ankuesja, në shumë raste është pjesë e postimeve të bëra nga profile të ndryshme në rrjete sociale, profile të cilat janë në mbrojtje të kafshëve. Gjithashtu, pikëpamjet e saj në lidhje me të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve, ankuesja rezulton që ti ketë bërë publike edhe nëpërmjet komenteve në lidhje me situata ose problematika të publikuara në faqe *online* apo rrjetin social “Facebook” që kanë patur në fokus problematikat e kafshëve të dhunuara, të braktisura apo të humbura, kundërshtimin për konsumimin e mishit të kafshëve apo çështjen e vrasjes së kafshëve.

Sa më sipër Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja i mbart në mënyrë të vërtetë bindjet animaliste, si aktiviste për të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve, dhe rrjedhimisht rezulton i provuar shkaku i “*bindjeve filozofike*”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.*

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, interpreton: “*E drejta për punë që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetues, është një e drejtë e individit në sensin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion*

është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.”

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton:

*“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Mbështetur në nenin 17, të Kushtetutës, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), zë një vend të veçantë në hierarkinë e normave juridike. KEDNJ-ja, nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore*

të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European, sanksionon në nenin 21 “Mosdiskriminimi” se: “ 1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, moshë apo orientimi seksual.”

Kodi i Punës, mbi bazën e të cilit janë rregulluar marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe punëdhënësit, në nenin 9, sanksionon: “ 1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 3. Ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar nga ky Kod, nuk zbatohet nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. 5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;... ”

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe

qëllimit që synohet të realizohet¹⁷. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁸. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”¹⁹

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme²⁰.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Sipas LMD, një nga format e shfaqjes së diskriminimit është “*diskriminimi i drejtpërdrejtë*”. Sipas nenit 3, pika 2, të LMD, “*diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “*1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi. 2. Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj*”.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Gjithashtu, ky ligj është përfaruar

¹⁷ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹⁸ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

¹⁹ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, *Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Dhoma e Madhe* 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

²⁰ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

plotësisht me standartet e Bashkimit European, konkretisht me katër Direktiva në këtë fushë²¹. Për këtë arsye, kuptimi dhe zbatimi i tij duhet bërë në frymën e direktivave të BE-së dhe standarteve të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European. Vendi ynë si vend anëtar i Këshillit të Europës dhe që ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duhet që të veprojë në përputhje me Konventën dhe me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si organi që mbikëqyr zbatimin e saj.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”,* si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

²¹ Ligji është përafshuar plotësisht me: 1. Direktivën e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*; 2. Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*; 3. Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”*; 4. Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për *“Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”*.

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin²².

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.*”²³ Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: “*..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.*”²⁴

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “*....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e*

²² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232

²³ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²⁴ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkakë diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljes diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

- (i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;
- (ii) shkaku i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një “shkak i mbrojtur” sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
- (iii) dhe arsyeja për këtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standardin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesja është diskriminuar për shkak të bindjeve filozofike, bazuar në konstatimet e mëposhtme:

- Rezultoi e provuar se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit/RTSH.
- Zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen nuk ka ndodhur për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuale sikurse pretendon punëdhënësi/RTSH, pasi ankuesja nuk ka qenë duke ushtruar detyrat e saj si e punësuar pranë punëdhënësit, por qëndrimi dhe deklarimi i bërë nga ankuesja, i cili është konsideruar nga punëdhënësi si në kundërshtim me Standardet Profesionale të RTSH, është kryer në profilin e saj privat në rrjetin social “Facebook”.
- Është pikërisht postimi që ankuesja ka bërë në lidhje me festën e Bajramit, por ku referon edhe tek festa e Pashkëve, që ka shërbyer si motivacion për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen, duke i konsideruar qëndrimet dhe opinionin e publikuar të ankuses, si gjuhë urrejtje me bazë fetare. Pra, në këtë rast, e drejta e punësimit të ankuses (zgjidhja e kontratës së punës) është cenuar nga punëdhënësi për shkak të bindjeve si animaliste të manifestuara publikisht nga ana e saj.
- Bindjet e personave të cilët mbrojnë të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve, pra të animalistëve, gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut “bindje filozofike”, të parashikuar nga

neni 1, i LMD dhe se ankuesja i mbart në mënyrë të vërtetë bindjet animaliste si aktiviste për të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve.

- Si punëmarrëse ankuesja në mënyrë legjitime duhet të vazhdonte punën për sa kohë që ajo nuk ka shkelur detyrimet që i burojnë nga kontrata e punës, që mund të justifikonin largimin e saj nga puna. Megjithatë, ankuesja u largua nga puna për shkak të publikimit në profilin e saj në *facebook* të qendrimit kritik në lidhje me therjen e kafshëve për festën fetare të Bajramit, por edhe atë të Pashkëve. Situata e ankuses është e krahasueshme me atë të punonjësve të tjerë në RTSH, sepse ajo është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se cilido nga kolegët e saj, vetëm për arsye të pikëpamjeve të saj si animaliste në lidhje me therjen e kafshëve.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kjo përbën një trajtim të diferencuar dhe më pak të favorshëm, në bazë të bindjeve filozofike, midis personave të gjendur në një situatë të ngjashme, në rastin konkret të ankuses, të cilës i është zgjidhur kontrata e punës në raport me punëmarrësit e tjerë.

Pra, rezulton se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm (zgjidhja e kontratës së punës) dhe se ky trajtim ka ardhur për shkak të bindjeve të saj animaliste, dhe se bindjet animaliste gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut të bindjeve filozofike.

Trajtimi i diferencuar/trajtimi më pak i favorshëm, jo në çdo rast përbën diskriminim. Trajtimi i diferencuar/trajtimi më pak i favorshëm, është diskriminues nëse ai nuk bazohet në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në këto kushte, duke ju rikthyer fakteve dhe rrethanave të çështjes në shqyrtim, si dhe bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon punëdhënësit/RTSH të provojë, që trajtimi i padrejtë të cilit i është nënshtruar ankuesja, pra zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen ndjek një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura (zgjidhjes së kontratës së punës) dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin e punëdhënësit/RTSH për cenim të imazhit me arsyetimin se, qëndrimet e ankuses referuar festës së Kurban Bajramit janë shprehur në një gjuhë të papërshtatshme për një gazetare të ngarkuar me detyrën e mbulimit të eventeve dhe ngjarjeve kulturore dhe se ato vijnë në kundërshtim me parimet e parashikuara në Kodin e Etikës, Parimeve Editoriale dhe Standardeve Profesionale, sepse ankuesja pikëpamjet e saj nuk i ka shprehur dhe bërë publike gjatë përmbushjes së detyrave të saj si gazetare e RTSH. Punëdhënësi/RTSH nuk mund të pretendojë për cenim të imazhit si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve që burojnë nga kontrata e punës, për sa kohë që qëndrimet që janë bërë shkak që punëdhënësi të ndërpresë

marrëdhënien e punës bien jashtë fushës së marrëdhënieve të punës, pasi ankuesja nuk ka qenë duke ushtruar profesionin si gazetare apo të ketë qenë duke kryer ndonjë detyrë të ngarkuar nga punëdhënësi.

Referuar vendimit të punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen, por edhe parashtrimeve të mbajtura gjatë shqyrtimit të ankesës, punëdhënësi/RTSH pretendon se qëndrimet e ankueses për festën e Bajramit, përbëjnë gjuhë urrejtje për shkak të bindjeve fetare. Pavarësisht se në rastin konkret, punëdhënësi/RTSH nuk mund të ndëshkojë ankuesen me zgjidhje të kontratës së punës për shkelje të detyrimeve të kontratës së punës me pretendimin se ajo ka përdorur gjuhë urrejtje, për sa kohë që qëndrimet apo komentet e pretenduara si gjuhë urrejtje janë bërë jashtë kontekstit të marrëdhënies së punës dhe nuk kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet që qëndrojnë midis ankueses si punëmarrëse dhe RTSH si punëdhënëse, Komisioneri vlerëson se nuk jemi në kushtet kur postimi i bërë nga ankuesja mund të konsiderohet gjuhë urrejtje, në kuptim të LMD.

Sipas nenit 3, pika 8, të LMD, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Në vlerësimin e faktit nëse gjuha e përdorur arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t’u konsideruar gjuhë urrejtje, në kuptim të nenit 3, pika 8, të LMD dhe rrjedhimisht një formë diskriminimi, e ndaluar nga ligji, në praktikën e tij Komisioneri bazohet në udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore e GJEDNJ dhe standardet e Këshillit të Europës, në lidhje me gjuhën e urrejtjes, siç është Rekomandimi KM/Rek (2022) 16, i Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI-t) “Për Luftimin e Gjuhës së Urrëjtjes”.

Rekomandimi KM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, thekson se, në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin se cila lloj përgjegjësie, nëse ka vend për përgjegjësi, duhet t’i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, duhen ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimi ndërmjet tyre: - përmbajtja e shprehjes; - konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; - qëllimi i folësit; - roli dhe statusi i folësit në shoqëri; - si shpërndahet apo përfordhet shprehja; - aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; - natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

Në vlerësimin e ashpërsisë së shprehjeve dhe përcaktimin nëse ato përlligjin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t’u konsideruar gjuhë urrejtje, elementët/faktorët që merren në konsideratë nuk vlerësohen veçmas njëri tjetrit, por vlerësimi i ashpërsisë së gjuhës së përdorur është rezultat i ndërveprimit midis tyre.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në një shoqëri demokratike, duhet të jetë e mundur të kritikohen idetë fetare, edhe nëse një kritikë e tillë mund të perceptohet nga disa si lënduese ndaj ndjenjave të tyre fetare. Në këtë kontekst, në çështjen *Aydin Tatlav kundër Turqisë* (Nr.50692/99, vendimi i datës 02.05.2006), GJEDNJ, konstatoi se dënimi i një gazetari për publikimin e një libri që kritikon fuqishëm fenë, kishte cënuar lirinë e shprehjes të parashikuar nga neni 10, i KEDNJ-së. Ankuesi, ishte një gazetar dhe autor i një libri të quajtur *İslamiyet Gerçeği* (Realiteti i Islamit). Ai parashtronte kryesisht idenë se feja kishte efektin e legjitimitetit të padrejtësive sociale duke i portretizuar ato si "Vullneti i Zotit". Në këtë çështje GJEDNJ, konstatoi se, disa pjesë të librit përmbanin kritika të forta ndaj fesë në sferën social-politike. Megjithatë, Gjykata nuk perceptoi një ton fyes në komentet që synonin drejtpërdrejt besimtarët ose një sulm abuziv kundër simboleve të shenjta, veçanërisht ndaj myslimanëve, të cilët me leximin e librit mund të ndiheshin megjithatë të ofenduar nga komentet për fenë e tyre.

Komisioni i Venecias thekson se, në një shoqëri demokratike, grupet fetare duhet të tolerojnë, siç duhet të bëjnë dhe grupet e tjera, deklarata publike kritike dhe debate rreth aktiviteteve, mësimave dhe besimeve të tyre, me kusht që një kritikë e tillë të mos përbëjë nxitje të urrejtjes dhe nxitje për të prishur qetësinë publike ose për të diskriminuar përkrahësit e një feje të caktuar.²⁵ Thënë kjo, Komisioni i Venecias nuk mbështet liberalizmin absolut. Ndërsa nuk ka dyshim se në një demokraci të gjitha idetë, edhe pse tronditëse apo shqetësuese, në parim duhet të mbrohen (me përjashtim, të atyre që nxisin urrejtje), po aq e vërtetë është se jo të gjitha idetë meritojnë të qarkullojnë. Meqenëse ushtrimi i lirisë së shprehjes mbart detyra dhe përgjegjësi, është legjitime të pritët nga çdo anëtar i një shoqërie demokratike që të shmangë sa të jetë e mundur shprehjet që shprehin përbuzje ose janë fyese pa dashje ndaj të tjerëve dhe cenon të drejtat e tyre.²⁶

Një fyerje ndaj një parimi ose një dogme, ose ndaj një përfaqësuesi të një feje, nuk do të thotë domosdoshmërisht një fyerje ndaj një individi që beson në atë fe.²⁷

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të qartë se një sulm ndaj një përfaqësuesi të një kishe nuk diskrediton dhe nënçmon automatikisht një pjesë të popullsisë për shkak të besimit të tyre në fenë përkatëse²⁸ dhe se kritika e një doktrine nuk përmban domosdoshmërisht sulme ndaj besimeve fetare si të tilla²⁹. Komisioni i Venecias nënvizon se duhet të jetë e mundur të kritikohen idetë fetare, edhe nëse një kritikë e tillë mund të perceptohet si lëndim i ndjenjave fetare³⁰.

Në këto kushte, qëndrimet e shprehura dhe të bëra publike nga ankuesja në rrjetin social "facebook", në lidhje me therjen e kafshëve për festat fetare, Bajram apo edhe Pashkë, janë një manifestim i

²⁵ Raport "Mbi marrëdhënien midis lirisë të shprehjes dhe lirisë së feje: Çështja e rregullimit dhe ndjekjes penale të blasfemisë, fyerjes fetare dhe nxitje për urrejtje fetare", miratuar nga Komisioni i Venecias, në Seancën Plenare të 76-të (Venecia, 17-18 tetor 2008), prg.72.

²⁶ Si më sipër, prg.73.

²⁷ Si më sipër, prg. 77.

²⁸ GJEDNJ, *Klein kundër Sllovakisë*, vendim i 31 tetorit 2006, prg. 51.

²⁹ GJEDNJ, vendimi *Guiniewski kundër Francës* i 31 janarit 2006, prg. 51.

³⁰ Raport "Mbi marrëdhënien midis lirisë të shprehjes dhe lirisë së feje: Çështja e rregullimit dhe ndjekjes penale të blasfemisë, fyerjes fetare dhe nxitje për urrejtje fetare", miratuar nga Komisioni i Venecias, në Seancën Plenare të 76-të (Venecia, 17-18 tetor 2008), prg.76.

bindjeve animaliste që ankuesja ka si një aktiviste për të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve dhe sado kritike që ato të jenë në raport me fenë, për sa kohë që nuk nxisin urrejtje apo armiqësi ndaj besimeve fetare, nuk mund ndalohen apo ankuesja të cenohet në të drejtën për punësim dhe profesion.

Ankuesja pretendoi se, është pushuar nga puna pas një takimi të rastësishëm që ka patur me Kryetarin e Bashkisë së Gjirokastrës, gjatë kohës që ajo ishte duke ndjekur dhe raportuar për Festivalin e Gjirokastrës, të cilit i ka shprehur shqetësimin për helmimet e qenve të rrugës në këtë qytet. Pas këtij takimi, ankuesja pretendon se është njoftuar nga punëdhënësi se duhet të kthehej në Tiranë dhe të ndërpriste raportimin e saj.

Bazuar në parashtrimet e palëve dhe dokumentacionin e administruar rezultoi e provuar se, ankuesja ka qenë pjesë e grupit të punës, që punëdhënësi/ RTSH ka ngritur për të ndjekur Festivalin e Gjirokastrës, i cili do të nisej nga data 23.06.2023 deri më datë 02.07.2023.

Referuar shkresës nr.566/8 prot, datë 22.06.2023“*Propozim për nisjen e grupit të xhirimit në Gjirokastrë*”, të Njesisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, grupi i xhirimit i ngarkuar me ndjekjen e Festivalit të Gjirokastrës, përbëhej nga: M.A-gazetar, G.K -operator dhe B.C-shofer. Me shkresën nr.57/8 prot., datë 18.03.2025, punëdhënësi/RTSH konfirmoi se, ankuesja së bashku me operatorin dhe shoferin është nisur për Gjirkastrë në datë 23.06.2023, sipas propozimit të bërë me shkresën nr. 566/8 prot datë 22.06.2023. Por, me shkresën nr. 566/14 prot datë 29.06.2023, nga Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve është bërë një propozim tjetër për mbulimin e Festivalit të Gjirokastrës dhe është dërguar për këtë qëllim gazetarja znj.A.A , e cila ka ndjekur evenimentin deri në përfundimin e tij, ndërsa ankuesja është kthyer në Tiranë përpara përfundimit të evenimentit.

Referuar shkresës nr. 566/14 prot datë 29.06.2023, konstatohet se, Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve ka propozuar ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e Festivalit të Gjirokastrës të përbërë nga: A.A – gazetar dhe B.C – shofer. Sipas kësaj shkrese, ky grup pune do të nisej më datë 30.06.2023 dhe do të kthehej më datë 02.07.2023.

Sa më sipër rezulton se, ankuesja edhe pse ka qenë e caktuar për ndjekjen e Festivalit të Gjirokastrës nga data 23.06.2023 – 02.07.2023, është kthyer në Tiranë nga punëdhënësi përpara përfundimit të këtij eventi, më konkretisht më datë 30.06.2023, pa asnjë shpjegim apo motivacion, duke u caktuar në vendin e saj gazetarja A.A . Asnjë nga pjestarët e tjerë të grupit të punës të caktuar me shkresën nr. 566/8 prot, datë 22.06.2023 nuk ka ndryshuar, por vetëm ankuesja është kthyer tre ditë para se të përfundonte aktiviteti.

Në propozimin e ri që Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve ka bërë me shkresën nr.566/14 prot datë 29.06.2023, nuk jepet asnjë arsye për ndryshimin e grupit të punës dhe nuk ka asnjë propozim për largimin e ankueses nga grupi i punës dhe kthimin e saj në Tiranë. Me shkresën nr. 57/8 prot, datë 18.03.2025, RTSH deklaroi se nuk disponon asnjë shkresë për arsyet e këtyre ndryshimeve, si dhe asnjë akt për mënyrën se si është njoftuar ankuesja në lidhje me këto ndryshime.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u faktua pretendimi i ankueses lidhur me takimin e zhvilluar me Kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë dhe diskutimi në lidhje me problematikën e helmimeve të qenve të rrugës në këtë qytet, por rezultoi e provuar se ankuesja në datat 23.06.2023 -29.06.2023 ka qenë në qytetin e Gjirokastrës duke raportuar për llogari të RTSH për Festivalin e Gjirokastrës dhe është kthyer në Tiranë pa asnjë lloj justifikimi tri ditë para përfundimit të këtij evenimenti.

Nga verifikimet e kryera në internet, u konstatua se ankuesja është etiketuar duke u bërë pjesë e një postimi në rrjetin social “facebook” nga profili me inicialet E.K, ku trajtohet dhe ngrihet shqetësimi i vrasjes dhe helmimit të qenve dhe maceve të rrugës në Gjirokastrë, postim i cili mban datën 24.05.2023. Njëkohësisht me ankuesen, në këtë postim është etiketuar edhe profili që Bashkia Gjirokastrë ka në këtë rrjet social. Pra, ky postim në lidhje me problematikën e vrasjes dhe helmimit të qenve dhe mace të rrugës në qytetin e Gjirokastrës, ku ankuesja është bërë pjesë, daton rreth një muaj para pjesëmarrjes e saj si gazetarë që raporton nga Gjirokastra.

Faktet e mësipërme provojnë se, në kohën kur ankuesja pretendon që të ketë ndodhur takimi me kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë, ajo është gjendur në qytetin e Gjirokastrës duke raportuar si gazetarë për llogari të RTSH, Festivalin e Gjirokastrës dhe se, sikurse pretendohet nga ankuesja, ajo është kthyer nga punëdhënësi/RTSH në Tiranë pa asnjë justifikim tri ditë para përfundimit të Festivalit të Gjirokastrës. Nga ana tjetër, postimi i datës 24.05.2023, ngre dyshime të arsyeshme se, pikëpamjet animaliste në mbrojtje të të drejtave të kafshëve në qytetin e Gjirokastrës, kanë qenë të njohura për Bashkinë Gjirokastrë dhe rrjedhimisht edhe për kryetarin e saj, me të cilin ankuesja pretendon se është takuar dhe i ka përcjellë shqetësimin në lidhje me situatën e kafshëve në këtë qytet.

Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi/supozimi se diskriminimi ka ndodhur (diskriminim prima facie)*, punëdhënësi/RTSH, ka barrën e provës që të provojë të kundërtën, pra që zgjidhja e kontratës së punës së ankueses nuk përbën diskriminim. Këtë, punëdhënësi/RTSH, mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve filozofike/bindjeve animaliste dhe trajtimit (zgjidhjes së kontratës së punës) të ankueses, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankueses se zgjidhja e kontratës së punës përbën diskriminim.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm ndaj të cilit është ekspozuar ankuesja, pra zgjidhja e kontratës së punës, për shkak të bindjeve filozofike/bindjeve si animaliste në mbrojtje të të drejtave dhe mirëqënies së kafshëve, nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo punëdhënësi që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të

drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret bindjet filozofike, përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës me ankuesen, sa kohë që punëdhënësi/RTSH ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuses nuk është bërë për shkak të bindjeve filozofike ose se largimi është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në konkluzion të gjithë sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja M.A është diskriminuar nga Radio Televizioni Shqiptar për shkak të bindjeve filozofike/bindjeve animaliste në mbrojtje të të drjetave dhe mirëqënies së kafshëve, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës. Për rrjedhojë Radio Televizioni Shqiptar, ka shkelur dispozitat e Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, neni 1, neni 3, pikat 1 dhe 2, neni 5 dhe neni 12, pika 1, shkronja “c”.

Ankuesja M.A, ka kërkuar që Komisioneri të marrë masa për rikthimin e saj në pozicionin e punës.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuses konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuses dhe largimin e saj nga puna. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuses, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e rikthyer ankuesen në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të. Komisioneri çmon se rikthimi i ankuses në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjesëtim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase, që në rastin konkret është largimi nga puna i ankuesit.

Komisioneri vlerëson se urdhërimi i punëdhënësit për marrjen e masave për të rikthyer punonjësën e larguar nga puna për shkaqe diskriminuese, nuk vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Në nenin 9, pika 9, të Kodit të Punës sanksionohet: *“9. Në rastin kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”* Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi, është ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Në nenin 38 të këtij ligji, që rregullon procedurat e gjykimit të padisë për diskriminim përpara gjykatës, ligji përcakton se: *“Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”*. Nëpërmjet këtij parashikimi, ligji është kujdesur të përcaktojë se, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Kodi i Punës, në mënyrë të shprehur referon në dispozitat e ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, si ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj, përmes parashikimit në nenin 38 të tij, se dëmshpërblimi për diskriminimin përfshin ndër të tjera edhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, njeh të drejtën e personit që konstatohet se është larguar për shkaqe diskriminuese, që të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Pavarësisht se, rregullimet e mësipërme ligjore kanë të bëjnë me procedurat e shqyrtimit para gjykatës dhe jo përpara Komisionerit, ato tregojnë se, kuadri ligjor në fuqi ofron mbrojtje për rikthimin në punë të personit, i cili konstatohet se është larguar nga puna për shkaqe diskriminuese.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit, pasi me kushtin që të paguajë dëmshpërblimin për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë, sipas parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës, ai mund të largojë çdo punonjës bazuar në një shkak të mbrojtur nga legjislacioni.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses M.A, për shkak të bindjeve filozofike/bindjeve animaliste në mbrojtje të të drejtave dhe mirëqënies së kafshëve, në të drejtën për punësim, nga ana e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH).
2. Në referim të pikës 1, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesen M.A në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet filozofike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim